



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 23 shtator 2011, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Enis Kervan, Shaip Muja, Skënder Hyseni, Sabri Hamiti, Amir Ahmeti dhe Petar Miletqi.

Munguan: Hydajet Hyseni dhe Donika Kadaj- Bujupi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati- ZPRK.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 5 shtator 2011;
3. Njoftim nga grupi i punës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;
4. Plani i veprimit i Kuvendit për integritet evropian;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 5 shtator 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 5 shtator 2011, me vërejtjen që në fund të procesverbalit, fjala “deputetë” të zëvendësohet me fjalën “ambasadorë”.

3. Njoftim nga grupi i punës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës

Albin Kurti- Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, njoftoi se grupi i punës i ka mbajtur disa takime. Në kuadër të kësaj mbikëqyrjeje, është mbajtur një takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme me drejtorët e departamenteve përkatëse. Po ashtu, ai tha se grupi punës është takuar me ambasadorin e Kosovës në Republikën e Gjermanisë, z. Vilson Mirëdita dhe Hilmi Zogjanin, i ngarkuar me punë në Republikën e Çekisë. Grupi i punës, pasi nuk është në kontakt me ambasadorët tanë, të cilët gjinden jashtë vendit, e ka parë të arsyeshme të kontaktojë me ata përmes email-adresës së tyre, lidhur me zbatimin e ligjit, me qëllim që të nxirret një raport më gjithëpërfshirës. Grupi i punës e ka hartuar një draft - raport për punën e bërë gjërë më tani, i cili posa të plotësohet do të procedohet për shqyrtim në Komision.

4. Plani i veprimit i Kuvendit për integritet evropiane

Albin Kurti- Duke iu referuar veprimeve të propozuara për Komisionin për Punë të Jashtme nga Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropiane, tha se kanë mbetur edhe tre muaj për të ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara. Meqë ministri ka qenë i angazhuar dhe ende nuk i është përgjigjur ftesës së Komisionit, propozoi që të përsëritet ftesa lidhur me mundësinë e pjesëmarrjes së ministrit në Komision, apo të ndonjë përfaqësuesi apo zëvendësministri, për ta përmbushur këtë pikë. Po ashtu shtroi çështjen për të kërkuar raport me shkrim nga Qeveria lidhur me mundësinë e aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

- 1. Të përsëritet ftesa për ministrin Enver Hoxhaj për dëgjim në Komision për të prezantuar strategji gjithëpërfshirëse për përfaqësim të jashtëm, si dhe për anëtarësim në organet ndërkombëtare dhe organizatat sipas pikës 1 të P. 54 të Planit të veprimit të Kuvendit.*
- 2. Kërkesa për Raport nga Qeveria e Kosovës, lidhur me mundësinë e aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, të shtyhet për një kohë më të përshtatshme.*

5. Të ndryshme

- Kryetari i Komisionit njoftoi se Kuvendi e ka lejuar vizitën zyrtare të delegacionit të Komisionit në Republikën e Shqipërisë, që do të realizohet më 29 dhe 30 shtator 2011.
- Kryetari i Komisionit shtroi çështjen e vonesës së dorëzimit të ekspertizës nga eksperti Zejnullah Gruda lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare. Anëtarët e Komisionit autorizuan kryetarin e Komisionit që të bisedojë me prof. Zejnullah Grudën dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për përfundimin e ekspertizës.

3. Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, kryetari i Komisionit propozoi organizimin e një dëgjimi publik.

Anëtarët e Komisionit, pas një diskutimi lidhur me organizimin e dëgjimit publik, konstatuan se një dëgjim për Projektligjin do të kishte qenë i nevojshëm që të organizohej para angazhimit të ekspertit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti